



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	06	Br. Prot.	754/23
Nr. Fsq.		Data	
Br. Str.	04	Datum	18.04.2023
Nr. Page		Date	

PRISHTINË

DATE/A:	14.04.2023
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-711/23
PËR/ZA/TO:	z. Alban FETAHU, Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta në Radiotelevizionin e Kosovës
CC:	z. Shkumbin AHMETXHEKAJ, Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad EJUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Alban Fetahu, 'Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta në RTK'



Të nderuar,

Duke vepruar sipas kërkesës së parashtruar nga një palë e jashtme (në vijim: raportues i rastit), në të cilën kërkohen sqarime nëse ka konflikt të interesit me rastin (për)zgjedhjes së z. Alban Fetahut në pozitën 'Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta në RTK', duke qenë se i njëjti paraprakisht ka mbajtur pozitën e 'Komisionerit të Përgjithshëm' në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (në vijim: MINT), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. pika 1.1.1. dhe 1.1.4., të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 21, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nxjerrë këtë:

OPINION

Nuk është gjetur (konstatuar) se përzgjedhja e z. Alban Fetahu në pozitën 'Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta' në RTK, përbën konflikt të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Arsyetim

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pranuar një kërkesë me shkrim nga raportuesi i jashtëm (*shkresa nr.: DPKI-06-711/23*), me pretendime për konflikt të interesit, lidhur me zyrtarin e lartë z. Alban Fetahu, ku është theksuar se, *i njëjti në deklarinë e pasurisë 2021 ka*

mbajtur pozitën 'Komisioner i Përgjithshëm' në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Qeverinë e Kosovës, si dhe në deklarin e rregullt vjetor është deklaruar si 'Ministër-Këshilltar në EXPO-Dubai'. Në kërkesë gjithashtu theksohet se, z. Fetahu në kuadër të MINT ka shërbyer nga shtatori 2021, deri në mars 2022, ndërsa në tetor 2022, është zgjedhur Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta në Radiotelevizionin e Kosovës përmes një konkursi. Në të njëjtën kërkesë raportuesi i rastit gjithashtu ka shtruar pyetjet vijuese: nëse ka konflikt interesi zgjedhja e z. Fetahut në pozitën e udhëheqësit të shërbimeve të përbashkët në RTK? A është pozitë politike, pozita që z. Fetahu ka mbajtur në MINT? A keni pranuar kërkesë nga RTK gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për këtë çështje?

Me qëllim të sqarimit të kësaj situate dhe pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar dhe mbledhur dokumentacionin relevant (DPKI-06-711/23), nga Radiotelevizioni i Kosovës (në vijim: RTK), dhe më pas ka realizuar një takim me zyrtarin e lartë z. Alban Fetahu, i cili është njoftuar lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me këtë rast. I njëjti ka ofruar informacionet e kërkuara dhe gjithashtu ka paraqitur qëndrimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura për këtë rast.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën e raportuesit të rastit, informatat dhe sqarimet që z. Alban Fetahu ka paraqitur lidhur me rastin në fjalë, përfshirë dokumentacionin e dorëzuar në Agjenci, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

- Me datë 25.09.2021, zv. Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me vendimin nr. ref.:367/2021, emëron z. Alban Fetahu 'Komisioner të Përgjithshëm' të Republikës së Kosovës në Expo 2020, në Dubai;

- Pas emërimit në këtë pozitë të z. Alban Fetahut, i njëjti në pajtim me Ligjin nr. 04/l-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, ka bërë deklarin me rastin e marrjes së detyrës më 18.10.2021, më pas deklarin e rregullt vjetor më 25.03.2022, si dhe deklarin pas mbarimit të funksionit më 30.05.2022.

- Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në shtator 2022, i drejtohet kryetarit të Bordit të RTK-së për aprovim të kërkesës për shpallje të konkursit publik për pozitën: 'Udhëheqësit të Shërbimeve të Përbashkëta', dhe pas miratimit të kësaj kërkesë nga Bordit i RTK-së, me datë 16.09.2022, RTK ri-shpall konkursin publik (nr. Ref.: 2012), për një (1) vend pune 'Udhëheqës të Shërbimeve të Përbashkëta në RTK';

- Më datë 20.09.2022, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së merr vendim (nr. i ref.: 3477/22), për formimin e komisionit prej pesë (5) anëtarëve për shqyrtimin, seleksionimin e aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve të paraqitur në konkursin publik, për vendin e punës 'Udhëheqës të Shërbimeve të Përbashkëta' në RTK, i rishpallur me datë 16.09.2022, nga ana e RTK-së;

- Me datë 13.10.2022, në bazë të Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës Nr.04/L-046, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe vendimit të Bordit të RTK-së të datës 13.10.2022, me nr. Protokolli 0186/22, lidhet kontratë e punës në mes të RTK-së dhe z. Alban Fetahu, të punësuar në cilësinë e 'Udhëheqësit të Shërbimeve të Përbashkëta' të RTK-së.

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe dispozitat e Ligjit për Parandalimin e

Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nxorri konstatimet si në dispozitiv të këtij opinionioni, me arsyetimin si vijon:

Konstatimi si në dispozitiv të këtij opinionioni, se, nuk është gjetur që (për)zgjedhja e z. Alban Fetahu në pozitën ‘Udhëheqës i Shërbimeve të Përbashkëta’ në RTK, përbën konflikt të interesit, është nxjerrë pas shqyrtimit të informatave dhe dokumentacionit në dispozicion, informatave dhe sqarimeve të dhëna në takim me zyrtarin e lartë, dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen e zyrtarit (të lartë) në ushtrimin e funksioneve publike, ndërsa në rastin konkret, z. Alban Fetahu nuk është gjetur të jetë përfshirë në ndonjë vendimmarrje të tillë, pasi që i njëjti në rastin konkret ka qenë vetëm pjesëmarrës në konkurs, në cilësi të kandidatit të jashtëm.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pasur gjithashtu parasysht [Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike], të përcaktuara me nenin 18, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku:

1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:

1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre;

Por, edhe pse zyrtari i lartë (z. Alban Fetahu), është punësuar në pozitë udhëheqëse pa kaluar periudha dy (2) vjeçare nga përfundimi i funksionit publik, megjithatë, dispozita e sipërcituar nuk vlen dhe nuk zbatohet në rastin konkret, pasi që, *detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, nuk kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të institucionit (të ri) punëdhënës, në këtë rast, RTK-së.*

Gjatë trajtimit të rastit, është gjetur gjithashtu se zyrtari i lartë z. Alban Fetahu, figuron të jetë bashkë-pronarë/aksionarë në biznesin privat ‘ASCEND-ENERGY’ SH.P.K.¹, dhe se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka shqyrtuar dhe pasur parasysht [Papajtueshmëritë me ushtrimin e funksionit publik], nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku përcaktohet se:

1. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.

¹ Statusi i këtij biznesi në ARBK rezulton të jetë pasiv nga data: 09/06/2022.

OF K...

Por, kjo situatë nuk bie ndesh me dispozitën e sipërcituar, pasi që zyrtari i lartë z. Alban Fetahu nuk është *menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës* i subjektit privat në fjalë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, rastin në fjalë e ka trajtuar në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që i jep Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligji (nr. 08/L-017), për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, prandaj nuk ka trajtuar pretendimet tjera (eventuale) që nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht janë jashtë kompetencave dhe mandatit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ligji nr. 08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me dispozitat vijuese të nenit 5, ka përcaktuar se:

1. Agjencia është përgjegjëse për:

“1.1. Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, që përfshijnë:

1.1.1. Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë;

1.1.2. Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive siç parashihet me ligj;

1.1.3. Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;

1.1.4. Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;

1.1.5. Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Ndërsa, neni 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit [Qëllimi], përcakton se:

“Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve”.

Gjithashtu, neni 2 i po të njëjtit ligj [Fushëveprimi], përcakton se:

“Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë parimet, rregullat dhe procedurat lidhur me sjelljet e lejuara dhe të ndaluara të zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrës publike si dhe masat e parapara për shkeljen e dispozitave të përcaktuara në këtë ligj. Ky ligj rregullon gjithashtu procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës publike si dhe detyrat e përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse”.

Ky opinion i referohet situatës konkrete lidhur me pretendimet për konflikt të interesit dhe nuk trajton çështje tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!